



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

№ 21863 Prot

Tiranë, më 27.5.2017

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi të brendshëm (me procedurën e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë brenda sistemit doganor)

Drejtuar: **DREJTORIVE NË D.P.DOGANAVE
DEGËVE DOGANORE**

Për publikim: Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të Kreut II dhe III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 921 datë 29.12.2014 “Për personelin e Administratës Doganore”, i ndryshuar, shpall konkurimin e brendshëm për pozicionin:

- **Specialist** në Drejtorinë e Mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale, Kategoria C1, Kategoria e pagës III- b (një vend)

Përshkrim përgjithësues për pozicionin:

- Lexon, kupton dhe zbaton legjislacionin për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale në territorin doganor shqiptar, bashkëpunon me Drejtorinë Juridike për sqarime dhe interpretime, bashkëpunon me Drejtorinë e TI dhe drejtori të tjera në DPD për zbatimin e ligjit në sistemin doganor duke dhënë sugjerimet e nevojshme informohet për ndryshime dhe mendimet më të fundit ligjore që ndikojnë në punën e DMPI dhe informon përkatësisht Drejtorinë e Drejtorisë.
- Administron me profesionalizëm kërkesat e klientave të paraqitura pranë *D.M.P.I-së*. duke mbajtur në vëmendje respektimin e afateve kohore, proceduriale dhe trajtimin e çështjeve në mënyrë profesionale. Ushtron në mënyrë të përshtatshme dhe efikase, kompetencat e deleguara me ligj dhe harton shkresat për Drejtorinë e Drejtorisë dhe për titullarët e Institucionit.
- Asiston Drejtorinë e Drejtorisë në hartimin e planeve të trajnimit të DPD për të përmirësuar nivelin e ekspertizës të punonjësve të DMPI dhe të degëve doganore; dhe për

të përditësuar kurrikulat e trajnimit të administratës doganore për çështjet e pronësisë intelektuale.

- Asiston Drejtorin e Drejtorisë në hartimim dhe/ose bashkëpunon për aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale duke kontribuar në fushata ndërgjegjësimi, kktivitete të ndryshme si panaire, konferenca etj sipas rastit.

Kandidatët që konkurojnë për këtë vend pune duhet të plotësojnë këto kritere:

Kriteret minimale:

- Të ketë një vlerësim pozitiv apo një certifikatë/vërtetim për një kualifikim të posaçëm profesional, që i përshtatet vendit të ri të punës
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi
- Të përmbushë kriteret e veçanta në shpalljen për konkurim
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar

Kriteret e veçanta:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit të parë dhe “Master Profesional” ose diploma të barazvlefshme me të sipas legjislacionit të arsimit të lartë në shkencat ekonomike, juridike, natyrore, shoqërore, politike etj.
- Të ketë mbi 2 vjet eksperiencë pune në Administratën Doganore.

Për të qenë pjesëmarrës në konkurrim, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm brenda datës 06.10.2017 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:

1. Kërkesë për marrje pjesë në testim
2. Curriculum Vitae
3. Rekomandim nga eprori direkt.

Procedura e përzgjedhjes do të bëhet në mbështetje të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e të ulët dhe të mesme drejtuese”, vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, “Për personelin e administratës doganore”, i ndryshuar.

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë!

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike "www.dap.gov.al".

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Belinda Ikonomi

